


STRATEGJIA

PËR MBROJTJEN E TE DHËNAVE PERSONALE

2014-2017



Angazhimi ynë për vitet 2014-2017 do të bazohet në shprehjet:

GARANCI
BASHKËPUNIM
CILËSI
MONITORIM
KONSOLIDIM
PËRPARËSI
NXITJE
KONTROLL
BASHKËVEPRIM

për mbrojtjen e të dhënave personale.

PËRMBAJTJA

■ PROGRESI NË MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE GJENDJA AKTUALE

■ VIZIONI YNË PËR VITET 2014-2017

■ PRIORITETET

I. NDËRGJEGJËSIMI

OBJEKTIVAT

I.I. ZHVILLIMI I MARRËDHËNIEVE PRIORITARE ME MEDIAN TRADICIONALE DHE ATË SOCIALE.

I.II. SENSIBILIZIMI I GRUPMOSHAVE TË REJA NË LIDHJE ME RREZIQET E PRIVATËSISË NGA PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË SË RE DUKE E NGRITUR NË NJË NIVEL MË TË STRUKTURUAR NËPËRMJET BASHKËPUNIMIT ME INSTITUCIONET SHETËRORE.

II. ZHVILLIMI I KUADRIT LIGJOR

OBJEKTIVAT

II. I. IMPLEMENTIMI I LMDHP

Dhënie mendimi.

Mbrojtje të të dhënave sensitive.

Përshtatje me rregulloren e BE-së pas miratimit të saj.

Përshtatje me Konventën 108 pas modernizimit të saj.

II. II. SHTRIRJA E LIGJIT NË SEKTORË TË VEÇANTË

Hartim dhe miratim të akteve nënligjore.

Amendime.

II. III. HARTIMI I KODIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.

Standart i një niveli të lartë

II.IV. DIMENSIONI GLOBAL I MBROJTJES SË TË DHËNAVE.

Qartësimi dhe thjeshtësimi i rregullave dhe procedurave në lidhje me transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale.

III. MONITORIMI I LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.

OBJEKTIVAT

III.I MENAXHIMI I PROCESIT TË NJOFTIMIT

Vlerësimi ligjor i përpunimit të të dhënave personale sipas deklarimeve përmes formularit të njoftimit.

Regjistrimi i njoftimeve në regjistrin elektronik online të kontrolluesve dhe sistemi i menaxhimit të dokumentacionit.

III.II NDËRMARRJA E “VEPRIMEVE AKTIVE”

Trajtimi i ankesave dhe inspektimet mbi bazën e ankesës.

Kontrolli dhe inspektimi administrativ.

Kontrolle kryesisht mbi bazën e planit.

Kontrolle kryesisht mbi bazën e njoftimit.

Vendosja e masave administrative dhe ndjekja e zbatueshmërisë së vendimeve me gjobë.

III.III TRANSPARENCA.

III.IV BASHKËPUNIMI ME PERSONAT E KONTAKTIT/TË NGARKUAR.

Kanali i komunikimit me Personat e kontaktit/të ngarkuar.

Bashkëpunimi me ASPA.

Bashkëpunimi me shkollën e magistraturës, etj.

III.V PËRMIRËSIMI I BURIMEVE NJERËZORE, TEKNIKE DHE ORGANIZATIVE.

III.VI MENAXHIM EFEKTIV I BURIMEVE FINANCIARE.

IV. PLATFORMAT E REJA TEKNOLOGJIKE TË E-GOVERNMENT NË LINJË ME MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DHE BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL.

V . MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE.

Bashkëpunimi me agjencinë e Bashkimit Evropian EUROJUST.

Bashkëpunimi me T-PD.

Organizimi i konferencës rajonale, me autoritetet e mbrojtjes së të dhënave personale të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore.

Organizimi i Konferencës së Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Frankofonisë në Shqipëri.

Ndjekja në vazhdimësi e Projektit “Joint Project of the Balkan Data Protection Authority”.

Aplikim për përfitim të projekteve, vizitave studimore, trajnimeve në kuadër të instrumenteve financuese të BE-së apo rrjeteve të ndryshme në fushën e mbrojtjes së të dhënave.

■ REZULTATET PRITSHME.

■ PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE



PROGRESI NË MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE – GJENDJA AKTUALE

Fillimi i punës në këtë drejtim kurrsesi nuk do të harrohet. Shënjim ishte ngritja e autoritetit dhe këmbëngulja do të ishte çdo realizim detyre, përmbushje kërkese me qëllimin e vetëm të bërit progres. Kërkoj përkushtim dhe bashkëpunim pesëvjeçari që sapo lamë dhe në fakt në shumë drejtime të kësaj fushe të rëndësishme bëjmë progres.

Arritëm të rekrutojmë staf me standarte dhe patëm pritshmëri pozitive. Plotësuam kuadrin e brendshëm ligjor dhe intensivisht zhvilluam ndërgjegjësimet për t'i njohur aktorët e këtij procesi me të drejtat dhe detyrimet përkatëse. Punuam brenda kornizës legjislativë dhe politikave tona, duke qenë të pavarur dhe objektiv. Kemi ruajtur standardet më të larta të sjelljes, duke bërë atë që është e drejtë edhe nëse ajo është e papëlqyeshme. Kemi shpjeguar se çfarë jemi duke bërë dhe përse, në një gjuhë të qartë të arritshme për të gjithë. Gjithashtu jemi udhëhequr nga pragmatizmi duke kuptuar nevojat e palëve të interesuar dhe kërkimin e zgjidhjeve praktike.

Ishim të suksesshëm në plotësimin e detyrimeve të parashikuara në pyetësonin e liberalizimit të vizave, në rekomandimet e përcaktuara në Progres Raportin e Shqipërisë dhe në këtë të fundit jemi etiketuar vazhdimisht me nota pozitive.

Zhvilluam kuadrin ligjor deri edhe në amendime të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Falë punës sonë të pa ndalur luajtëm rol kryesor në përmbushjen me efektivitet të zbatimit të projektit EU IPA/2009 që në disa komponentë na asistoi për rreth tre vite. Kjo punë përmbushi disa pritshmëri në hartimin me sukses të udhëzimeve në sektorë të veçantë, në hartimin e

manualeve në disa fusha specifike të ushtrimit, seminare e trajnime në numër të konsiderueshëm dhe në atë që e quajtmë mjaft të rëndësishme në certifikimin e personave të ngarkuar në disa institucione publike të cilët do të jenë ura lidhëse midis Komisionerit dhe kontrolluesit.

Marrëdhënia me monitoruesin, Kuvendin e Shqipërisë ka qenë e përmuajshme dhe ka reflektuar progres në rezolutat nga njëri vit raportimi në tjetrin.

Komunikimi në grup apo në shkallë hierarkike pa ndrojtje dhe me seriozitet ka treguar që është shembulli më i mirë i realizimit në kohë e me cilësi i çdo detyre dhe përgjegjësie.

Sigurisht që ky mision sapo ka nisur, por në vëmendjen tonë institucionale çdo hap është dhe do të jetë i mirëmenduar dhe pa dyshim që progresi do të ketë rritje të kurbës me dëshirën dhe përmbushjen e qëllimit tonë për të ruajtur privatësinë e individit përmes zbatimit me efektivitet të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.



VIZIONI I KOMISIONERIT PËR VITIN 2014-2017

Mbrojtja e të dhënave në Shqipëri, sikundër në të gjithë botën, përbën një sfidë gjithnjë në zhvillim. Mbledhja dhe përdorimi i të dhënave personale në mënyrë të drejtë e të ligjshme është objekti themelor i punës tonë me qëllim garantimin e respektimit të parimeve ligjore të përcaktuara në këtë fushë.

Vizioni ynë është të angazhohemi intensivisht dhe në mënyrë të qëndrueshme në mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve shqiptarë duke kryer veprime konkrete për zbatimin e ligjit dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve.

Qëllimi i Autoritetit tonë mbështetet në parimin e besueshmërisë. Shoqëria jonë ka nevojë të kuptojë, të përdorë dhe të jetë e informuar në lidhje me të drejtat dhe detyrimet që i përkasin në këtë dimension të zhvillimit shoqëror, profesional dhe individual.

Themeli i punës tonë rrjedh nga ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nga një instrument tjetër ligjor kombëtar apo ndërkombëtar i miratuar apo i detyrueshëm, i cili na obligon me mbikëqyrjen e çdo përpunimi të dhënash personale nga shteti, biznesi apo çdo kontrollues tjetër.

Si përfundim, ulja e rreziqeve të cënimit të të dhënave personale të shoqërisë dhe individëve, përbën thelbin e misionit tonë.



PRIORITETET

I. NDËRGJEGJËSIMI

OBJEKTIVAT

LI ZHVILLIMI I MARRËDHËNIEVE PRIORITARE ME MEDIAN TRADICIONALE DHE ATË SOCIALE.

Ky objektiv do të arrihet nëpërmjet vazhdimit dhe përmirësimit të marrëdhënieve me Median duke dhënë Deklarata për Shtyp sa herë e konsiderojmë të rëndësishme në lidhje me temat e ditës, në opinionin publik. Është e rëndësishme të jemi aktual (do të tërheqim vëmendjen e medias në momentin që deklarata jonë është koherente në lidhje me çështjet e ditës dhe do kemi një vizibilitet më të madh në media dhe për rrjedhojë do të jemi më afër subjekteve të Ligjit) sepse kështu jemi më pranë individit si fokusi i punës sonë.

Vazhdimi i përditësimit të profilit Facebook si dhe përdorimi i të gjithë mundësive të medias online duhet të jetë prioritar pasi jep një vizibilitet më të madh te subjektet e ligjit.

Gjithashtu publikimi i:

- Revistës “Ligj dhe Privatësi”;
- Botimeve të ndryshme;
- Fletëpalosjeve në lidhje me tema konkrete;

të cilat mund të shpërndahen në raste të eventeve; të jenë të pranishme në institucion për publikun e interesuar apo të bëhet një shpërndarje e programuar e tyre në bazë të nevojave specifike të sektorëve të caktuar.

Gjithashtu, vizibilitet më të madh në Media do të ketë transmetimi i spoteve televizive në televizionet dhe oraret me shikueshmëri të lartë.

Konkretisht masat që do të merren për realizimin e këtij objekti do të jenë:

- ▶ Organizimi i Konferencave për shtyp në lidhje me Opinionin e Komisionerit;
- ▶ Organizimi i një Konferencë të madhe vjetore me rastin e 28 Janarit, ditës Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave Personale;
- ▶ Realizimi i një ose dy spoteve televizive dhe transmetimi i tyre në televizionet kombëtare;
- ▶ Përgatitja e Revistës periodike “Ligj dhe Privatësi”;
- ▶ Publikimi i fletëpalosjeve me tema të ndryshme për mbrojtjen e të dhënave personale;
- ▶ Përditësimi i faqes Zyrtare www.kmdp.al dhe profilit në Facebook;
- ▶ Përdorimi i teknologjive të reja opensource dhe mediave sociale.

Bashkëpunimi me drejtoritë e KMDP	DÇPLMJ
Bashkëpunimi me Institucionet Publike	TVSH-në
Bashkëpunimi me organizma ndërkombëtarë	Autoritet Homologe

I.II SENSIBILIZIMI I GRUPMOSHAVE TË REJA NË LIDHJE ME RREZIQET E PRIVATËSISË NGA PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË SË RE DUKE E NGRITUR NË NJË NIVEL MË TË STRUKTURUAR NËPËRMJET BASHKËPUNIMIT ME INSTITUCIONET SHTETËRORE.

Teknologjia përparon çdo ditë e më shumë, madje dhe tani që flasim diku është duke u shpikur një aplikacion, një metodë, një mënyrë e re komunikimi që përdor të dhënat personale ose ndërhyr në një farë mënyre në jetën personale. Kjo ndodh në një kohë kur shoqëria, jo vetëm shqiptare por ajo evropiane dhe botërore nuk ka qenë e përgatitur për një revolucion të tillë dhe për këtë arsye i

lind detyrë Autoriteteve si Komisioneri për të bërë të mundur ndërgjegjësimin e lartë të rinisë në lidhje me këto rreziqe. Kjo tendencë vërehet te të gjithë Autoritet Evropiane dhe Botërore, ku në çdo seminar, aktivitet, Konferencë Ndërkombëtare apo dhe në faqet zyrtare të Homologëve një rëndësi e madhe i kushtohet kësaj grupmoshe dhe këtyre tematikave.

Për këtë arsye Autoriteti i Komisionerit duhet të bashkëpunojë me institucionet shtetërore si Ministria e Arsimit ose dhe Ministria e Rinisë për ngritjen në nivel institucional të ndërgjegjësimit të këtyre grupmoshave veçanërisht atyre parauniversitare.

Një aktivitet që mund të kryhet është përfshirja në kurrikulat e një ose disa lëndëve të shkollës 9 vjeçare dhe të mesme të temës së mbrojtjes së jetës private/ mbrojtja e privatësisë gjatë lundrimit në internet ose në rrjete sociale/ mbrojtja e privatësisë gjatë përdorimit të aplikacioneve, etj. Këto mund të jenë me një frekuencë 1 mujore ose 3 mujore në lëndët e edukatës qytetare apo informatikës, ose te të dyja.

Gjithashtu trajnimi i mësuesve dhe personave kompetent do të kryhet nga Autoriteti i Komisionerit. Materialet e reja të publikuara nga Autoriteti i Komisionerit do të dërgohen me postë ose email pranë DAREVE të rretheve. Gjithashtu Autoriteti i Komisionerit do të garantojë prezencën e tij në rast kërkese nga këto mësues në orën e caktuar për këtë trajnim.

Nga ana e Autoritetit të Komisionerit do të punohet për sjelljen në kohën reale të të gjithë informacionit për rreziqet e privatësisë nëpërmjet përkthimeve dhe publikimeve të ndryshme.

Në këtë kuadër është me interes krijimi i një newsletter të veçantë për mësuesit e shkollave 9 vjeçare dhe të mesme.

Gjithashtu, në këtë 4 vjeçar do të hartohet një projekt me qëllim mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi me të dhënat personale i cili do të prezantohet organizmave financues.

Për sa i përket grupmoshës universitare ndërgjegjësimi i tyre do të vazhdohet nëpërmjet leksioneve të hapura ose konferencave të cilat mund të organizohen 1 herë në vit falë nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me UT dhe në të ardhmen me universitete të tjera në bazë edhe të kërkesës së tyre.

Përditësimi i profilit në facebook dhe faqes zyrtare me informacione të rëndësishme nga mbrojtja e të dhënave personale mund të rrisë ndërgjegjësimin te kjo grupmoshë.

Bashkëpunimi me drejtoritë e KMDP	DÇPLMJ
Bashkëpunimi me Institucionet Publike	Ministrinë e Arsimit dhe Ministrinë e Rinisë; M/Inovacion dhe Administratën Publike
Bashkëpunimi me organizma ndërkombëtarë	TAIEX

II. ZHVILLIMI I KUADRIT LIGJOR

KMDP do të konsideronte si një nga arritjet më të mëdha të vitit 2012, miratimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Projektligji në fjalë u hartua me ndihmën e Projektit EU-IPA 2009 “Përforcimi i Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

OBJEKTIVAT

II.I IMPLEMENTIMI I LMDHP

■ Dhënie mendimi

Një nga problemet e hasura nga praktika është numri i pakët i projekt/akteve të dërguara për mendim pranë Autoritetit të Komisionerit. Me gjithë punën e vazhdueshme të autoritetit lidhur me zbatimin e detyrimit ligjor të të gjithë institucioneve publike për dërgimin e projekt/akteve ligjore e nënligjore për mendim, megjithë nxitjet dhe tryezat e organizuara deri më tani nuk ka rezultuar përmbushje maksimale e këtij detyrimi.

Autoriteti i Komisionerit do të insistojë sërish për zbatimin e këtij detyrimi ligjor duke kërkuar:

- ▶ Bashkëpunim më të ngushtë me Kuvendin e Shqipërisë dhe Ministrin për Marrëdhëniet me Parlamentin;
- ▶ Rikërkim të ndryshimit të Rregullores së KM;
- ▶ Takime intensive me personat e kontaktit/të ngarkuar;
- ▶ Takime me drejtoritë juridike;
- ▶ Përshtatja e ligjeve më të rëndësishme vendase përmes iniciativës sonë(*afat gjatë*).

Autoriteti i Komisionerit do të realizojë në vazhdimësi:

- ▶ Ndërgjegjësimë;
 - ▶ Trajnime;
- do të zhvillojë:
- ▶ Publikime;
- do të informojë me:
- ▶ shpjeguese, etj;

■ Mbrojtje gjatë përpunimit të të dhënave sensitive

- Përpunimi i të dhënave sensitive, të tilla si të dhëna që kanë të bëjnë me origjinën racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimin, fetar apo filozofik, dënimin penal, si dhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale, aktualisht është parashikuar në LMDHP duke vendosur disa kritere dhe duke siguruar masa të përshtatshme sigurie. Megjithatë, zhvillimet e reja në teknologji dhe zhvillimet e tjera sociale kanë nxjerrë në pah domosdoshmërinë e vlerësimit nga ana e Komisionerit për përfshirjen e kategorive të tjera të të dhënave në përkufizim, si dhe qartësimin e kushteve dhe masave të sigurisë për përpunimin e tyre.

Kjo duhet të përfshijë kategori të tilla si psh, të dhënat biometrike, të dhënat gjenetike të cilat aktualisht nuk janë të përcaktuara shprehimisht si të dhëna sensitive.

- Po kështu, LMDHP ka parashikuar në nenin 7 dispozitën si vijon:

Përpunimi i të dhënave sensitive bëhet vetëm nëse: c) *autorizohet nga autoriteti përgjegjës për një interes të rëndësishëm publik, nën masa të përshtatshme mbrojtëse;*

Nga praktika e deritanishme Autoriteti i Komisionerit nuk ka marrë asnjë kërkesë për një autorizim të tillë. Nisur nga ky fakt, është detyrë e Komisionerit për të vazhduar punën me ndërgjegjësimin e kontrolluesve për këtë detyrim ligjor si dhe për hartimin e një dokumenti shpjegues për lehtësimin e zbatimit të kësaj dispozite. Një hap më konkret do të ishte dhe lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të cilat gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre përpunojnë kryesisht të dhëna sensitive, siç mund të jetë rasti me Ministrinë e Shëndetësisë.

Autoriteti i Komisionerit do të synojë:

- ▶ Përfshirjen e përkufizimeve të reja të disa kategorive të tjera të të dhënave në përputhje me aktet ndërkombëtare;
- ▶ Përcaktimin e kushteve dhe masave të sigurisë për përpunimin e tyre;
- ▶ Krijimin e mundësive për zbatueshmërinë e detyrimit ligjor për autorizim.

■ Përshtatje me rregulloren e BE-së pas miratimit të saj.

Adresimi i këtij prioriteti është afatgjatë për vet faktin që kjo Projekt/Rregullore ende nuk është miratuar. Propozimet e Komisionit do të kalojnë në Parlamentin Evropian dhe Shtetet Anëtare të BE (Takimi në Këshillin e Ministrave) për diskutim. Rregullorja do të jetë e zbatueshme në të gjitha Shtetet Anëtare dy vjet pas miratimit. Shtetet Anëtare do të kenë një afat prej dy vjetësh në transpozimin e dispozitave të saj në ligjin kombëtar.

■ Përshtatje me Konventën 108 pas modernizimit të saj.

Gjatë vitit 2011, autoriteti i Komisionerit ka paraqitur disa propozime për tu përfshirë në ndryshimet e Konventës 108. Gjatë diskutimeve të bëra përgjatë vitit 2012, konkretisht në të dy takimet e organizuara nga T-PD, propozimet e

dërguara nga autoriteti i Komisionerit janë diskutuar dhe disa prej tyre janë marrë në konsideratë.

Miratimi i propozimeve të dërguara për modernizimin e Konventës 108, nga shtetet anëtare të T-PD, lejon procedurën e kalimit për miratim pranë Komitetit të Ministrave. T-PD i ka propozuar Komitetit të Ministrave që t'ia besonte finalizimin e propozimeve komitetit *Ad-Hoc* “CAHDATA”. Ky Komitet do të fillojë punimet e tij më 12-14 Nëntor 2013. Takimet e radhës janë parashikuar përgjatë vitit 2014.

Modernizimi i Konventës do të gjejë zbatim në të gjitha Shtetet Anëtare të cilët e kanë ratifikuar atë.

Miratimi i këtyre propozimeve ngarkon Autoritetin e Komisionerit me detyrën e përshtatjes së LMDHP dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij me Konventën e Modernizuar.

II.II SHTRIRJA E LIGJIT NË SEKTORË TË VEÇANTË.

■ Hartim dhe miratim të akteve nënligjore

- ▶ udhëzime në sektorë të veçantë;
- ▶ manuale;
- ▶ udhëzues.

■ Amendimet

Në vitet në vijim synojmë të propozojmë ndryshime të reja ligjore në përputhje me aktet ndërkombëtare dhe praktikën e hasur nga Drejtoria e Hetim-Inspektimit.

Amendimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar në kuadër të:

- ▶ Efekteve që do të sjellë miratimi i Rregullores së Përgjithshme të BE-së “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe modernizimi i Konventës 108.
- ▶ **“Përmbushjes së detyrimit ligjor për të njoftuar”** duke përcaktuar një afat kufi për zbatimin e tij nga kontrolluesit që në aktivitetin e tyre përpunojnë të dhëna personale (ata që kryejnë përpunim automatik).
- ▶ Përfshirjes së përkufizimit “Oficer i mbrojtjes së të dhënave personale” si dhe detajimit të kompetencave dhe rolit të tij.

- ▶ Ndryshimeve ose miratimit të LDI-së(Ligji për të Drejtën e Informimit) nëse KMDP do të jetë autoriteti përgjegjës për zbatimin e tij.
- ▶ Përputhshmërisë ligjore që do të kërkohet pasi të arrihen ndryshime në legjislacione të tjera të domosdoshme këto të fundit për proceset e shumta që kryejnë me të dhënat personale. Pra, krahas propozimeve që do të kërkojmë në ligje të tjera (si psh. në legjislacionin tatimor, etj) do të amendojmë edhe legjislacionin tonë. Kjo do të kontribuojë në procedurat specifike të përmirësimit dhe rritjes së efikasitetit të hetimeve administrative.

Bashkëpunimi me drejtoritë e KMDP	D.H.I ; D.R ; DMP
Bashkëpunimi me Institucionet Publike	Kuvendi, Kryeministria, Ministri për Marrëdhëniet me Parlamentin, MD, MB, etj.
Bashkëpunimi me organizma ndërkombëtarë	Ekspertë të ofruar nga TAIEX, KE apo projekte të tjera të ngjashme.

II.III HARTIMI I KODIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Hartimi i këtij Kodi do të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore, në veçanti të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale.

Kodi do të përfshijë pothuajse të gjitha fushat në të cilat shoqëria jonë ushtron aktivitete.

II.IV DIMENSIONI GLOBAL I MBROJTJES SË TË DHËNAVE

- **Qartësimi dhe thjeshtësimi i rregullave dhe procedurave në lidhje me transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale.**

Një nga çështjet më të rëndësishme në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, është edhe transferimi i të dhënave personale në vende që nuk kanë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave. Komisioneri ka ndërmarrë një sërë hapash dhe ka miratuar një seri aktesh nënligjore të cilat kanë synuar sqarimin dhe bërjen më të kuptueshme për kontrolluesit, të masave të sigurisë dhe respektimit të procedurave ligjore gjatë transferimit ndërkombëtar.

Aktualisht, Autoriteti i Komisionerit është duke punuar për të tërhequr dhe identifikuar të gjitha subjektet që realizojnë transferim ndërkombëtar të dhënash, do të lindë nevoja e parashikimit të rregullave të reja që përputhen me praktikat konkrete që mund të vijnë në të ardhmen.

Autoriteti i Komisionerit synon:

- ▶ Parashikimin e rregullave të reja që përputhen me praktikat ndërkombëtare duke arritur uniformitetin me to.
- ▶ Përditësimin e Listës së vendeve me nivel mbrojtje të mjaftueshme për transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale.

Bashkëpunimi me drejtoritë e KMDP	D.H.I ; D.R
Bashkëpunimi me Institucionet Publike	Ministria e Punëve të Jashtme.
Bashkëpunimi me organizma ndërkombëtarë	Ekspertë të ofruar nga TAIEX, KE apo projekte të tjera të ngjashme

III. MONITORIMI I LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.

OBJEKTIVAT

III.I MENAXHIMI I PROÇESIT TË NJOFTIMIT

Objektivi kryesor ndër vite i Drejtorisë së Regjistrimit ka qenë rritja e numrit të njoftimeve. Ky tregues është i lidhur ngushtë dhe shkon paralelisht me procesin e sensibilizimit të subjekteve kontrollues publikë dhe privatë, proces i cili ka qenë në rënie për shkak të listave të ezauruara tashmë të QKR-së, kthimeve të zarfave nga Posta Shqiptare me arsyen e adresave të pasakta apo të

pamjaftueshme. Për këto arsye sensibilizimi u mbështet në bashkëpunimin me sektorin e Arsimit. Krahasimisht me vitet e kaluara, viti 2013 ka shënuar një ulje të konsiderueshme të numrit të njoftimeve dhe për më tepër deklaratimet nga sektori privat kanë qenë krahasimisht shumë të ulëta në raport me atë publik.

Për realizimin e këtij objekti në vazhdimësi, të gjendur në këtë situatë, duhen studiuar mënyra të reja sensibilizimi dhe pasi sektori publik ka qenë më i ndjeshëm në përmbushjen e detyrimit ligjor, duhet vënë theksi në identifikimin e kontrolluesve privatë potencialë me qëllim nxitjen e deklaratimit nga ky i fundit.

Evidentimi i kontrolluesve privatë do të jetë një sfidë, për fitimin e së cilës do të kërkohet bashkëpunimi i vazhdueshëm me institucionet shtetërore.

Nisur shpesh nga mungesa e përgjegjshmërisë së subjekteve për të njoftuar, një bashkëpunim me Drejtorinë e HI me qëllim aplikimin e gjobës për kundërvajtje administrative për kontrolluesit që nuk përmbushin detyrimin ligjor për të njoftuar, do të shërbente si një këmbanë alarmi për shtrirjen e përgjegjshmërisë së sektorëve të ndryshëm.

Autoriteti i Komisionerit synon:

- ▶ Shtrirjen e kërkesave për bashkëpunim drejtuar Institucioneve të ndryshme publike, të cilët në zbatim të veprimtarisë së tyre kanë kontakte me sektorë të ndryshëm.
- ▶ Marrjen e masave shtrënguese për kontrolluesit që nuk përmbushin detyrimin ligjor për të njoftuar.

Bashkëpunimi me Institucionet Publike për identifikimin e kontrolluesve privatë potencialë të sektorëve të ndryshëm.	Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Urdhëri i Mjekëve, Urdhëri i Stomatologëve, Urdhëri i Farmacistëve.
Bashkëpunimi me drejtorinë e KMDP.	DÇPLMJ; DHI; DMP

- **Vlerësimi ligjor i përpunimit të të dhënave personale sipas deklaratimeve përmes formularit të njoftimit.**

Kontrolli paraprak me qëllim verifikimin e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave përmes vetëdeklarimit të kontrolluesve.

Një nga çështjet më të rëndësishme që ka kërkuar vëmendjen e Drejtorisë së Regjistrimit është vlerësimi në tërësi i deklarimit të përpunimit të të dhënave nëpërmjet formularëve të njoftimit. Me qëllim verifikimin maksimal të ligjshmërisë së deklaruar të përpunimit të të dhënave personale, në rastet e pamjaftueshmërisë së informacionit të pasqyruar në formular është kontaktuar me kontrolluesit nëpërmjet shkresave, email-eve apo telefonatave për saktësimin e deklarimit dhe marrjen e informacionit plotësues.

- ▶ Një vëmendje e veçantë gjatë kontrollit paraprak i është kushtuar përpunimit të të dhënave sensitive si dhe për më tepër theksit të respektimit të procedurave ligjore në zbatim të ligjit gjatë transferimit ndërkombëtar. Evidentimi i rasteve që kërkojnë Autorizimin e Komisionerit i përcillet DÇPLMJ-së.

Bashkëpunimi me drejtorinë e KMDP

DÇPLMJ; DHI

■ Regjistrimi i njoftimeve në regjistrin elektronik online të kontrolluesve dhe sistemi i menaxhimit të dokumentacionit.

Akti final i deklarimit nëpërmjet formularëve të njoftimit pas marrjes së informacionit të plotë, është kalimi në regjistrin elektronik të hapur për publikun, të kontrolluesve që përpunojnë të dhëna personale.

Çdo individ si subjekt të dhënash mund të konsultojë regjistrin elektronik të kontrolluesve dhe të njihet me të dhënat personale që u përpunohen, qëllimin përkatës apo çdo informacion tjetër të nevojshëm.

Aplikimi i sistemit të ri të menaxhimit të dokumentacionit që përmban procesin e njoftimit, sjell një organizim më eficient për gjenerimin e statistikave të nevojshme si dhe u vjen në ndihmë të gjitha drejtorive për t'u konsultuar me informacionin e nevojshëm në mbarëvajtjen e procesit të njoftimit nga kontrolluesit.

Kjo kërkon përditësim adekuat të informacionit, por dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me personelin IT për identifikimin dhe zgjidhjen e problematikave të mundshme.

Bashkëpunimi me drejtoritë e KMDP

Akses në sistem nga ana e DÇPLMJ; DHI

Bashkëpunim me IT

III.II NDËRMARRJA E “VEPRIMEVE AKTIVE”

Një nga objektivat e politikës që do të vazhdojë të ndjekë Autoriteti i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është ndërmarrja e “veprimeve aktive” për të ndryshuar sjelljen dhe organizimin e kontrolluesve publikë dhe privatë që mbledhin, përpunojnë dhe mbajnë të dhëna personale, në kuadër të respektimit të parimeve të përgjithshme dhe legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Është e rëndësishme marrja e masave konkrete, të cilat nuk kanë vetëm karakter ndëshkues por edhe edukues e sensibilizues.

Mbikëqyrja si element bazë i veprimtarisë së Autoritetit të Komisionerit do të ushtrohet për të vlerësuar marrjen e masave konkrete nga kontrolluesit lidhur me problematikat e shqyrtuara nga ana e Komisionerit. Një nga prioritetet afatgjata të Autoritetit do të jetë bashkëpunimi maksimal me institucionet shtetërore me qëllim shtrirjen e inspektimeve në të gjithë territorin.

Kjo periudhë do të shoqërohet me rritjen e numrit të kontrolleve dhe inspektimeve administrative si dhe shtrirje më e gjerë në fusha të reja ku operojnë kontrolluesit, sipas planeve të mirëpërcaktuara, të cilat do të shoqërohen edhe me metodologji të reja dhe nëpërmjet bashkëpunimit me institucione brenda dhe jashtë vendit.

Minimizimi i shkeljeve dhe trajtimi i ankesave të subjekteve të të dhënave, nëpërmjet zbatimit të planit të kontrolleve të planifikuara sipas fushave, inspektimeve pa njoftim në raste të kufizuara me qëllim verifikimin, si dhe në rastet e disa ankesave dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Regjistrimit do të jenë fokusi i këtij katër vjeçari të ardhshëm.

Mbikëqyrja si detyrë funksionale e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, realizohet nëpërmjet *Drejtorisë së Hetim Inspektimit* në procesin e trajtimit të ankesave, zhvillimit të kontrolleve dhe inspektimeve administrative, kryerjes së hetimeve administrative me qëllim zbatimin e ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar dhe

udhëzimeve të nxjerra në funksion të tij, nga të gjithë kontrolluesit dhe përpunuesit që mbledhin dhe përpunojnë të dhëna personale duke qenë kështu subjekte të zbatimit të këtij ligji.

Strategjia e DHI-së lidhur me mbikëqyrjen synon në bërjen sa më profesionale dhe cilësore në zhvillimin e këtij procesi dhe në koherencë me nevojat që dikton vendi, me synimin që të gjithë kontrolluesit dhe përpunuesit të arrijnë të kuptojnë dhe zbatojnë ligjin jo vetëm si një detyrim ligjor, por dhe një domosdoshmëri e kohës dhe perspektivës drejt anëtarësimit në BE.

Synohet që ky zbatim i ligjit nga kontrolluesit dhe përpunuesit e të dhënave të arrihet pikërisht nëpërmjet mbikëqyrjes dhe monitorimit dhe jo nëpërmjet të diktuarit për vendosjen e tyre përballë sanksioneve administrative.

Rritja e numrit të kontrolleve dhe inspektimeve administrative si dhe shtrirje më e gjerë në fusha të reja ku operojnë kontrolluesit. Mundësi për ndryshime ligjore në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” përsa i përket kompetencave të kësaj Drejtorie, si dhe ndarjes së të ardhurave që do të vinin nga masat administrative me gjobë në një raport të caktuar (*një pjesë e të ardhurave duhej të planifikohej për tu derdhur në buxhetin e Komisionerit*).

Të bëhet publikimi për rezultatet e kontrolleve dhe inspektimeve.

KMDP

■ Trajtimi i ankesave dhe inspektimet mbi bazën e ankesës.

Do të realizohen statistika mbi bazën e numrit dhe natyrës së ankesave, si dhe kontrolluesve ndaj të cilëve ngrihen pretendimet. Vendimmarrja do të jetë proporcionale dhe e bazuar në reagimin e kontrolluesve dhe interesin publik.

Do të vijojmë intensivisht të asistojmë subjektet duke i orientuar saktësisht mbi veprimet dhe mënyrat që duhet të ndjekin me qëllim ushtrimin e të drejtave të tyre. Gjithashtu, parësore do të mbetet edhe informimi në vijim i ankuesit mbi rezultatet e inspektimit, si dhe do të orientohet për të realizuar të drejtat e tij pranë kontrolluesit, nëse objekti i ankesës do të ishte mos-zbatimi i detyrimeve të kontrolluesit ndaj të drejtave ligjore të subjekteve të të dhënave.

Autoriteti i Komisionerit do të vazhdojë ti kushtojë vëmendje parësore trajtimit të ankesave duke i vendosur edhe në krye të axhendës së Drejtorisë së Hetimit

dhe Inspektimit. Kjo për faktin se qëllimi final dhe i thjeshtë i funksionimit të Autoritetit është mbrojtja e privatësisë së çdo individi (subjekt i të dhënave).

Në këtë kuadër për periudhën 2014-2017 synohet:

- ▶ Rritje e numrit të ankesave nëpërmjet nxitjes së drejtpërdrejtë të kontrolluesve për plotësimin e detyrimit të nenit 18 të ligjit;
 - ▶ Trajtimi i ankesave në një afat sa më të shkurtër;
 - ▶ Bashkëpunimi i drejtpërdrejtë me aktorët e përfshirë në objektin e ankimit, për një zgjidhje sa më optimale;
 - ▶ Trajtimi objektiv i ankesave në kuadër të rritjes së besimit të subjekteve të të dhënave personale ndaj Autoritetit të Komisionerit;
 - ▶ Krijimi i praktikave në trajtimin e tipologjive të ndryshme të ankesave.
-

Në lidhje me ankesat e ardhura në KMDP do të synohet një zgjidhje sa më e shpejtë dhe efikase për individin e dëmtuar duke vënë në vend të drejtën e tij dhe do të orientojmë kontrolluesin për ndërprerjen e veprimeve të tij në rastet e cënimit të privatësisë së ankuesit.

Për periudhën 2014-2017 do të përdoren mënyra komunikimi dhe takime të hapura me publikun në mënyrë që të ketë një orientim dhe kuptim më të mirë lidhur me përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të tyre, duke asistuar dhe orientuar ankuesit saktësisht mbi veprimet dhe mënyrat që duhet të ndjekin me qëllim ushtrimin e të drejtave të tyre. Kjo do të bëjë që numri i ankesave të shtohet dhe problematikat që ekzistojnë të verifikohen dhe kontrollohen nga ana e Drejtorisë së Hetim-Inspektimit. Vendimmarrja do të jetë proporcionale dhe e bazuar në ligj duke pasur gjithnjë si qëllim vendosjen e ligjshmërisë në përpunimin e të dhënave personale të shtetasve shqiptare.

Në planin strategjik do të synohet një ndërgjegjësim i vazhdueshëm i subjekteve të të dhënave personale nga strukturat e Komisionerit, për të kuptuar të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga ligji nr. 9887 dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, me qëllim rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit të subjekteve të të dhënave personale, të cilët në rastin më të parë të keqpërdorimit të të dhënave të tyre personale nga kontrollues të ndryshëm, të drejtojnë ankesat pranë Autoritetit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave.

Jo të gjitha ankesat që mbërrijnë pranë Autoritetit të Komisionerit janë rast për tu trajtuar nga Drejtoria e Hetim Inspektimit. Në DHI do të orientoohen ankesa që përbëjnë rast të shkeljes dhe keqpërdorimit të të dhënave personale të bazuar në prova dhe fakte dhe që për këto ankesa duhet fillimi i një procedure hetimi administrativ.

DHI-Ankues-DMP

Rritje e numrit të ankesave nëpërmjet nxitjes së drejtpërdrejtë të kontrolluesve për plotësimin e detyrimit të nenit 18 të ligjit;

Trajtimi i ankesave në një afat sa më të shkurtër;

Bashkëpunimi i drejtpërdrejtë me aktorët e përfshirë në objektin e ankimit, për një zgjidhje sa më optimale;

DHI-Ankues-DMP

Trajtimi objektiv i ankesave në kuadër të rritjes së besimit të subjekteve të të dhënave personale ndaj Autoritetit të Komisionerit;

Krijimi i praktikave në trajtimin e tipologjive të ndryshme të ankesave;

Të përcaktohen në një kohe shumë të shkurtër se cilat ankesa do të shqyrtohen me anë të inspektimeve dhe cilat ankesa duhet të marrin një përgjigje të shpejtë.

Të respektohet kërkesa ligjore që fillimisht ankuesi duhet të drejtohet tek kontrolluesi.

DHI-Ankues-DMP

Ankuesit i jepet ndihma e duhur juridike në mënyrë që ankimi i tij të shqyrtohet në bazë të kritereve që kërkon ligji.

Të informohet publiku me anë të mediave si dhe përmes faqes sonë në internet, me qëllim rritjen e besimit të publikut për punën e Komisionerit dhe rritjen e ndjeshmërisë së publikut për të dhënat dhe jetën e tyre private.

Të realizohet informimi i ankuesit mbi rezultatet e inspektimit.

DHI-Ankues-DMP

■ Kontrolli dhe inspektimi administrativ

Do të synohet të mbahet i njëjti ritëm dhe një numër në rritje i inspektimeve dhe kontrolleve, kjo në varësi të numrit të ankesave dhe buxhetit në dispozicion. Analiza e riskut të cënimit të privatësisë dhe të dhënave personale do të jetë përcaktuese për parashikimin e kontrolleve administrative me plan (*ex-officio*), bazuar në gjetjet e viteve paraardhëse, tendencës së ankesave të paraqitura.

Metodologjia e vlerësimit të gjetjeve nga inspektimet dhe kontrollet dhe daljes me një vendim përfundimtar nga Autoriteti i Komisionerit mund të përmirësohet duke vijuar dhe intensifikuar takimet konsultative me strukturat e tjera të KMDP-së, informacionit të shkëmbyer midis nesh veçanërisht për zhvillimet legjislative në vend dhe vetë akteve të reja nënligjore të prodhuara nga Autoriteti i Komisionerit, si dhe dëgjimin dhe marrjen në konsideratë të opinionit paraprak të grupeve të interesit (përfaqësuesit e një grupimi të madh kontrolluesish).

Gjithashtu, specifikë e veçantë do të jetë shpërndarja e kontrolleve nëpër gjithë territorin e vendit. Vlerësojmë se duhet të rriten inspektimet jashtë Tiranës për çdo vit me 10-20 % të totalit të kontrolleve të planifikuara (kjo edhe sipas buxhetit të alokuar).

Afat Shkurtër:

- ▶ Zhvillimet më të fundit teknologjike do të jenë në fokusin e mbikqyrjes, përsa i përket pajisjeve dhe sistemeve të reja të prezantuara rishtazi në vendin tonë, pavarësisht fushës ku operon kontrolluesi. Kështu, prioritet për tu mbikqyrur për vitet 2014-2015 mund të jenë të gjitha përpunimet *online* (bazuar në internet) të kontrolluesve publik dhe privat, ku inspektori në bashkëpunim me specialistin IT të determinojë nga zyra ligjshmërinë e përpunimeve dhe më pas zhvillimin e kontrolleve pranë tyre për çështjen e sigurisë (nëse do të ishte e domosdoshme).
- ▶ Pavarësisht fushës, në vëmendje do të jenë përpunimet që përfshijnë kryesisht të dhënat sensitive dhe ato biometrike në kombinim me teknologjinë, pajisjet dhe softwaret (programet) e reja, çka është vërejtur të jetë shqetësuese edhe në vende të tjera së fundmi.
- ▶ Do të duhet të përmirësojmë metodologjinë gjatë zhvillimit të hetimeve tona nëpërmjet inspektimeve dhe kontrolleve administrative, së pari duke marrë në konsideratë ndryshimet/amendimet në Kodin e Procedurave Administrative (ka filluar puna nga institucionet), duke qenë më konsequent me Manualin e Inspektimit, Planet e Kontrollit, Alternimin e Inspektorëve me Specialistët IT, ndarjen e fushave për tu mbikëqyrur sipas inspektorëve

përkatësisht (pavarësisht se deri më tani volumi i punës, larmia e fushave ka qenë kufizuese dhe kushtëzuese), si dhe mirë shpërndarjes me periudha tremujore për të katër vitet për fushën specifike (p.sh. të themi se në tremujorin e parë të vitit 2014 do të mbikqyret dhe kontrollohet vetëm sektori shëndetësor, apo vetëm institucionet publike si policia, prokuroria, shërbimi informativ, apo mbikëqyrje vetëm për transferimin ndërkombëtar).

- ▶ Do të iniciohen kontrole administrative në bazë të një kërkimi të problematikave të hasura në median e shkruar dhe vizive që kanë lidhje me të dhënat personale. Kjo në bashkëpunim me Drejtorinë e Marrëdhënieve me Publikun, duke u bërë një punë paraprake, kërkimore nga kjo Drejtori për evidentimin e rasteve të shkeljes së privatësisë dhe më pas këto kontrole të realizohen nga Drejtoria e Hetim-Inspektimit.

Afatmesëm dhe Afatgjatë

- ▶ Përfshirja e oficerit të mbrojtjes së të dhënave/DPO/Personi Kontakt/i ngarkuar në procesin dhe procedurat e inspektimeve dhe kontroleve do të jetë determinuese, pasi, nëse ky person do të vetë mbikëqyrë kontrolluesin nëpërmjet auditimeve të brendshme periodike, do të kishim një rezultat të dyfishtë sepse së pari garantohej përpunimi i ligjshëm më në thelb dhe së dyti puna konkrete e tij do të vihej në dispozicion të grupit të inspektimit/kontrollit sapo të nisë hetimi (është e imagjinueshme sa do të lehtësohet puna dhe ngarkesa e inspektorit pasi të administrojë raportin mbi ecurinë dhe masat e sugjeruara nga DPO).
- ▶ Gjithashtu, veçanërisht për vitet 2016-2017 (pasi kërkon impenjim dhe punë paraprake gjithëpërfshirëse bashkëpunuese) do të realizojmë inspektime të përbashkëta me institucione të tjera të vendit (si p.sh. tatim-taksat, pasi kemi edhe marrëveshje të nënshkruar, AKEP pasi kemi krijuar eksperiencat e para, AKSHI, Policinë e Bashkive, etj), duke krijuar një praktikë ligjore ose duke e rregulluar atë me aktet përkatëse që këto struktura të mund të ushtrojnë kontrole/inspektime apo të njoftojnë/informojnë KMDP-në.
- ▶ Zhvillimi i inspektimeve dhe kontroleve të përbashkëta me homologët e huaj jo vetëm do të rriste efikasitetin në sigurinë e shtetasve tanë respektiv, por edhe do të ishte një formë e përsosjes së performancës së inspektorëve. Po kështu ky angazhim dypalësh apo edhe shumëpalësh do të përgatisë dhe do të jepte siguri inspektimit të KMDP-së në përputhje me zhvillimet më të fundit evropiane dhe ndryshimit pozitiv sipas axhendës evropiane të vendit tonë, duke patur parasysh jo vetëm statusin e vendit kandidat por edhe sfidat për të qenë pjesë e SHENGENIT, EUROPOL, EUROJUST, etj.

Kontrollet dhe inspektimet administrative që do të ushtrohen do të jenë të bazuara në praktikat më të mira të realizuara nga Drejtoria Hetim-Inspektimit. Këto praktika do të shërbejnë si modele tip për fusha të veçanta ku është ushtruar kontrolli apo inspektimi administrativ. Kontrollet dhe inspektimet administrative do të realizohen në mënyrë më të thellë, duke përzgjedhur kontrollues të tillë që impakti i tyre me subjektet e të dhënave personale është shumë i gjerë.

Kontrollet dhe inspektimet administrative janë dhe mbeten detyra organike dhe thelbësore e DHI-së. Në aspektin strategjik kontrollet administrative do të jenë gjithëpërfshirëse në objektin e tyre dhe do të orientohen drejt kontrolluesve dhe përpunuesve që kanë një impakt të madh dhe të drejtpërdrejtë në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale. Tashmë për kontrollet dhe inspektimet administrative pritet cilësi më e lartë, pasi autoriteti është konsoliduar, kuadri ligjor është përmirësuar, përvoja në kontrole dhe inspektime administrative është rritur, stafi i KMDP-së veçanërisht inspektorët e DHI-së, specialistët e IT-së janë profesionalizuar dhe trajnuar nga ekspertët e BE-së dhe çertifikuar në shumë aspekte të kësaj fushe.

<p>Prioritet për tu mbikqyrur për vitet 2014-2015 do të jenë përpunimet online.</p>	<p>DHI</p>
<p>Mirëshpërndarje e kontrolleve me periudha tremujore për të katër vitet për një fushë specifike. (p.sh. në tremujorin e parë të vitit 2014 do të mbikqyret dhe kontrollohet vetëm sektori shëndetësor, apo vetëm institucionet publike si policia, prokuroria, shërbimi informativ, apo mbikqyrje vetëm për transferimin ndërkombëtar).</p>	<p>DHI</p>
<p>Synohet realizimi i inspektimeve të përbashkëta me institucione të tjera të vendit.</p>	<p>DHI, Tatim-taksat, AKEP-i, AKSH-i, Policinë bashkiake.</p>
<p>Zhvillimi i inspektimeve dhe kontrolleve të përbashkëta me homologët e huaj.</p>	<p>DHI, Institucione Homologe.</p>
<p>Kontrolle administrative në bazë të një kërkimi të problematikave të hasura në median e shkruar dhe vizive që kanë lidhje me të dhënat personale.</p>	<p>Kjo në bashkëpunim me Drejtorinë e Marrëdhënieve me Publikun, duke u bërë një punë paraprake, kërkimore nga kjo Drejtori për</p>

evidentimin e rasteve të shkeljes së privatësisë dhe më pas këto kontrolle të realizohen nga Drejtoria e Hetim-Inspektimit.

■ **Kontrolle kryesisht mbi bazën e planit**

Do të vazhdohen të kryhen kontrolle kryesish mbi bazën e një plani të miratuar paraprakisht, kjo sigurisht në raport edhe me numrin e ankesave të ardhura pranë autoritetit. Këto kontrolle do të fokusohen në disa fusha, por kryesisht në ato të konstatuara si më problematike. Plani do të jetë sa më objektiv dhe konciz.

Plani do të synojë të prekë sa më shumë fusha, por do të synohet të përcaktohen fusha të reja për të kryer kontrolle administrative nga Drejtoria e Hetim Inspektimit. Në planet e kontrolleve të kësaj natyre, rëndësi të veçantë do të ketë ushtrimi i kontrolleve në kontrollues të mëdhenj ku problematikat janë më të shumta.

Këto kontrolle do të planifikohen të tilla që të shtrihen në të gjithë kontrolluesit e fushës si: bankat, pikat doganore, portet detare, misionet diplomatike, zyrat konsullore, kompanitë ajrore, universitete, spitale, etj. Ky plan do të synojë të ndjekë ritmin e zhvillimit të teknologjive të reja që përdoren nga kontrolluesit në mënyrë që të realizohet një mbrojtje sa më e mirë e mundshme e të dhënave personale.

Në planin e kontrolleve administrative do të mbahet parasysh që ato të orientohen ndaj çdo sistemi elektronik apo zhvillimi teknologjik që aplikohet nga kontrollues të ndryshëm publikë apo privatë në nivel qendror apo vendor me fokus mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale.

Gjatë viteve të kaluara janë kryer inspektime në kontrollues të ndryshëm. Në këto raste, Komisioneri është shprehur me akte të ndryshme dhe ka vendosur detyra për tu zbatuar nga kontrolluesit në rekomandimet e nxjerra. Herë pas here do të synohet realizimi i inspektimeve mbi zbatueshmërinë e Rekomandimeve, Urdhërave dhe Vendimeve të Komisionerit, të cilat do të synojnë implementimin e plotë të të gjitha akteve të miratuara nga Komisioneri, pasi zbatimi i akteve të Komisionerit përbën edhe fazën më të rëndësishme të të gjithë procesit të hetimit dhe inspektimit administrativ, me qëllim realizimin praktik të të drejtave të subjekteve të të dhënave dhe plotësimin e detyrimeve nga kontrolluesit.

Fushat kryesore ku do të realizohen kontrole administrative:

- ▶ Përdorimi i faqeve online nga kontrolluesit lidhur me garancitë për ti siguruar qytetarët për mbrojtjen e të dhënave personale të tyre.
- ▶ Përdorimi i internetit nga autoritetet e taksave dhe mbrojtjen e konfidencialitetit të tatimpaguesve.
- ▶ Përdorimi i rrjeteve sociale dhe problemet e paraqitura lidhur me mbrojtjen e privatësisë.
- ▶ Përdorimi i smartphones, tableta dhe sistemet informatikë lidhur me mbrojtjen e fëmijëve.
- ▶ Përdorimi i telemarketing lidhur me të drejtat e konsumatorëve.
- ▶ Mbrojtja e të dhënave personale të punëmarrësve dhe marrëdhënia e punësimit për të rregulluar aspekte të veçanta të privatësisë në vendin e punës.
- ▶ Mbrojtja e të dhënave personale në sistemin shëndetësor, arsim, fushata elektorale.
- ▶ Mbrojtja e të dhënave personale në fushën e komunikimeve elektronike lidhur me përgjimet, të dhënat e trafikut telefonik dhe të dhënat e transmetimit.
- ▶ Përdorimi i të dhënave biometrike.
- ▶ Përdorimi i të dhënave personale gjatë aktiviteteve kërkimore – shkencore.
- ▶ Përdorimi i të dhënave personale në pushtetin vendor dhe atë qendror lidhur me të drejtat që kanë subjektet e të dhënave personale.
- ▶ Përdorimi i CCTV-ve në sektorin privat dhe atë shtetëror.
- ▶ Zbatimi i rregullave për mbrojtjen e klientëve të bankave, për mbrojtjen e abonentëve telefonikë, për mbrojtjen e pacientëve, etj.
- ▶ Sektori bankar dhe institucionet e tjera financiare jo bankare. Planifikimi i kontroleve në këtë sektor është gjithmonë i nevojshëm për shkak të përpunimit të madh të të dhënave dhe informacioneve personale nga këta kontrollues në aspektin e ofrimit të shërbimeve bankare dhe sidomos kredidhënies dhe në mbledhjen e këtyre kredive.
- ▶ Fusha e shëndetësisë publike dhe private mbetet fusha me prioritet në caktimin dhe planifikimin e kontroleve administrative, për vetë zhvillimin që pritet të marrë ky sektor.
- ▶ Fusha e sigurimeve, kompanitë e sigurimeve, autoritetet mbikëqyrëse e financiare, korrespondentët, brokerat, etj.
- ▶ Sektori Arsimor i të gjitha niveleve.
- ▶ Telekomunikacionet.
- ▶ Pushteti vendor e qendror.
- ▶ Realizimi i politikave të sigurisë.
- ▶ Kategoritë e subjekteve të të dhënave personale.
- ▶ Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale.

- ▶ Përpunimi i të dhënave personale të punonjësve.
- ▶ Përdorimi i sms-ve promocionale dhe marketingu direkt.

Përcaktimi i fushave të reja për kontroll:

Banka, komunikimet elektronike, rrjete sociale, universitete, spitale, kompanitë e sigurimeve, autoritetet mbikëqyrëse financiare korrespondentët, brokerat, etj.

DHI, DÇPLMJ, DR

■ **Kontrolle kryesisht mbi bazën e njoftimit**

Në planin strategjik kontrollet kryesisht nisur nga njoftimet e kontrolluesve në Regjistrin e Njoftimeve pranë Komisionerit do të zënë një vend të rëndësishëm, me qëllim që kontrolluesit të kuptojnë që njoftimi pranë Komisionerit për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale nuk është formal dhe se detyrimi i tyre në marrëdhënie me Komisionerin dhe zbatimin e ligjit nuk është kaq, por nëpërmjet këtyre kontrolleve ballafaqohet gjendja e deklaruar e kontrolluesit në aspektin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale me atë që ai realisht bën në ushtrimin e veprimtarisë së tij.

Njoftimet që Kontrolluesit dërgojnë pranë Autoritetit të Komisionerit do të jenë objekt i kontrolleve administrative kryesisht, me qëllim që problematikat që dalin nga Drejtoria e Regjistrimit pranë Autoritetit të Komisionerit të verifikohen dhe të zgjidhen përmes këtyre kontrolleve. Sa i përket kësaj çështjeje, do të bashkërendohen përpjekjet midis DHI-së dhe DR-së në kuadër të kryerjes së kontrolleve bazuar në deklaratimet e bëra nga vetë kontrolluesit në njoftimin e kryer pranë KMDP-së. Në rastet e konstatimit të shkeljeve të ligjit ose në rast dyshimesh për praktika jo të ligjshme përpunimi, DR do të informojë DHI-në mbi baza periodike, në mënyrë që të kryejë inspektimet përkatëse.

Në bashkëpunim me Drejtorinë e Regjistrimit, çdo tre muaj, do të administrohet lista e subjekteve kontrollues të cilët nuk kanë njoftuar pranë Autoritetit të Komisionerit, ose iu është kërkuar informacion plotësues ose shtesë dhe nuk e kanë përmbushur këtë kërkesë. Te këta kontrollues do të ushtrohet kontroll administrativ dhe me konstatimin e shkeljes së detyrimit për të njoftuar do të gjobiten përkatësisht, si dhe do të vlerësohet tërësia për përpunimin e të dhënave personale që përbëjnë risk.

Bashkëpunim midis DHI-së dhe DR-së në kuadër të kryerjes së kontrolleve bazuar në deklaratimet e bëra nga vetë kontrolluesit në njoftimin e kryer pranë KMDP-së. Në rastet e konstatimit të shkeljeve të ligjit ose në rast dyshimesh për praktika jo të ligjshme përpunimi, DR do të informojë DHI-në mbi baza periodike, në mënyrë që të kryejë inspektimet përkatëse.

DHI-DR

■ Vendosija e masave administrative dhe ndjekja e zbatueshmërisë së vendimeve me gjobë.

Mendojmë se së paku, për vitet 2014-2015 (duke marrë në konsideratë se ende nuk do jenë mbushur 10 vjet nga ngritja e institucionit) do të duhet të tregohemi të vendosur në parashtrimin e shkeljeve dhe zgjidhjet e tyre nga kontrolluesit, duke iu lënë të hapur mundësitë e rivendosijes së të drejtës. Reagimi i kontrolluesve gjatë këtij procesi do të jetë determinues në vendimmarrjen e Komisionerit. Pra, nxitja për përmirësim duke i parashtruar problematikën (rekomandim ose urdhër) do të ishte më efiçente në arritjen e synimit dhe detyrës së mbikqyrjes nga ana e Autoritetit të Komisionerit, kjo shoqëruar me afate konkrete.

Kjo nuk do të thotë se marrja e masave administrative nuk do të mbetet opsion, por duke konsideruar rast pas rasti, veçanërisht reagimin e kontrolluesit, nëse është përsëritës, nëse ka pasur ankesë dhe veçanërisht nëse pasoja ka qenë e rëndë apo ka cënuar një numër të madh individësh (subjekte të të dhënave). Ndërsa, për periudhën 2015-2017 vendosja e gjobave mund të jetë më e menjëhershme.

Gjithashtu, do të bashkërendohet e konsolidohet puna me Shërbimin Përmbarimor Privat, duke paraqitur në kohë dhe të plotë dokumentacionin që do të bëjë të mundur zbatueshmërinë e vendimeve kthyer në “Titull Ekzekutiv”. Do të përzgjedhim ato kompani apo studio që me kohën do të tregojnë efektshmëri më të lartë në ndjekjen e procedurave dhe vjeljen e gjobave.

Bashkëpunim për zbatueshmërinë e vendimeve me gjobë.

Shërbimin Përmbarimor Privat

III.III TRANSPARENCA

Për këto katër vite informimi i publikut do të jetë i vazhdueshëm mbi aktet e Komisionerit në lidhje me përfundimin e kontrolleve dhe inspektiveve administrative. Informimi duhet të realizohet nëpërmjet mediave të të gjitha formateve, si dhe aktet do të publikohen në faqen zyrtare të internetit, çka do të kontribuojë në ndërgjegjësimin e të gjithë aktorëve, por edhe t'ju krijojë mundësi paraprake kontrolluesve të marrin masa të menjëhershme sipas rekomandimeve, urdhërave apo vendimeve të Komisionerit.

Transparenca me kontrolluesit, subjektet e të dhënave dhe publikun e gjerë është shumë e rëndësishme për imazhin dhe rritjen e besueshmërisë ndaj Autoritetit të Komisionerit. Kështu, bërja publike e të gjithë legjislacionit dhe dokumenteve të tjera me rëndësi për tu njohur nga të gjithë aktorët e interesuar, do të jetë një gur themeli kryesor i vendosjes dhe funksionimit të mëtijshëm të demokracisë, pasi siguron mundësinë që vetë qytetari të hulumtojë dhe padyshim në të mund të vendosemi përpara përgjegjësisë për plotësimin me përpikmëri të detyrimeve përkatëse. Përveç kësaj, kushdo do të mund të jetë i mirënjohur me mbrojtjen që i ofrohet përmes legjislacionit, do të jetë edhe më i arrirë individualisht për të kërkuar më shumë për ruajtjen e jetës së tij private.

Në këtë kuptim, kontrolluesit, subjektet e të dhënave personale dhe publiku i gjerë kanë mundësi të njihen dhe të japin mendimin e tyre për të gjitha projekt/aktet ligjore dhe nënligjore të Autoritetit të Komisionerit, përmes klikimit në një rubrikë të veçantë në faqen zyrtare të KMDP-së. E njëjta procedurë do të vazhdojë të ndiqet edhe në vitet që do të pasojnë.

Akte të tjera të rëndësishme siç janë Raporti Vjetor dhe Strategjia Institucionale do të vazhdojnë të publikohen në faqen zyrtare për të siguruar transparencë maksimale në sytë e publikut, të asaj çfarë angazhohemi të realizojmë dhe asaj që realizojmë në përfundim.

Në këtë kuadër do të realizohet publikimi i të gjitha akteve të Autoritetit të Komisionerit të parashikuara në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Aktet do të publikohen të plota duke paraqitur të gjitha faktet e konstatuara gjatë inspektimit dhe sanksionet përkatëse. Kjo do t'i bëjë kontrolluesit më të përgjegjshëm në marrëdhënie me subjektet e të dhënave.

Transparenca ndaj publikut përbën gjithashtu qëllimin primar të njoftimit, pasi infomacioni i siguruar nëpërmjet deklaratimit të kontrolluesve publikë dhe privatë pasqyrohet në regjistrin elektronik online të kontrolluesve, në faqen zyrtare të Autoritetit të Komisionerit të përditësuar në kohë reale. Në këtë mënyrë subjekteve të të dhënave u vihet në ndihmë për të kuptuar se si u përpunohen të

dhënat personale. Por, ky regjistër i shërben edhe rritjes së ndërgjegjësimit dhe përgjegjësisë edhe të vetë kontrolluesve.

Transparenca institucionale ndikon edhe në mirëfunksionimin e marrëdhënieve ndër-institucionale në kuadër të informimit reciprok mbi veprimtarinë e kryer dhe rritjes së bashkëpunimit për realizimin e objektivave të përbashkëta. Për çdo akt të miratuar nga Autoriteti i Komisionerit do të ketë një bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Marrëdhënieve me Publikun për publikimin në faqen zyrtare të KMDP-së të tyre (akteve) për të qenë sa më të hapur dhe transparent me publikun e gjerë.

Kjo do të thotë se ne do të synojmë një qasje pozitive dhe proaktive në sigurimin e pajtueshmërisë me LMDHP, në ndihmën dhe inkurajimin e kontrolluesve për të kuptuar dhe për të përmbushur detyrimet e tyre më lehtë.

Vendimet që merren nga Drejtoria e Hetim Inspektimit, do të jenë objekt i diskutimeve me të gjithë faktorët në Autoritetin e Komisionerit me qëllim që vendimmarrja të jetë transparente dhe e bazuar në ligj. Vendimet do të komunikohen dhe do të jepen në dispozicion të kontrolluesve dhe subjekteve të të dhënave personale të interesuar, të plota dhe me argumentet e duhura ligjore.

Gjithashtu në funksion të transparencës, titullari dhe drejtues të tjerë informohen mbi shpenzimet aktuale krahasuar me buxhetin e planifikuar nga nëpunësi zbatues i cili mbulon financat e institucionit. Informacioni i marrë ndihmon në vendimmarrjen e titullarit për shpenzimet e mëtejshme financiare.

Në kuadër të transparencës së përdorimit të fondeve publike si dhe të detyrimit ligjor të publikimit, kemi bërë publike dhe do të vijojmë publikimin në faqen zyrtare www.kmdp.al, raportet e monitorimit të shpenzimeve publike, së bashku me relacionin shpjegues në zbatim të legjislacionit financiar në fuqi.

KMDP për çdo vend vakant të krijuar në institucion, në zbatim të legjislacionit të shërbimit civil, ka bërë dhe do të vijojë të bëjë publike në portalin e saj, procedurën e konkurimit i cili do të jetë i hapur për çdo aplikant, duke respektuar kriteret e përcaktuara për pozicionin e kërkuar.

-Publikimi i të gjitha akteve të Autoritetit të Komisionerit të parashikuara në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

-Vendimet që merren nga Drejtoria e H-I të kenë akses në rrjetin e brendshëm për të gjithë drejtoritë e tjera të Autoritetit të Komisionerit.

-Vendimet të publikohen në faqen zyrtare të

DHI-DMP-DÇPLMJ-DSHM

Autoritetit të Komisionerit në internet.

-Të përgatiten botime (të paktën çdo 3 muaj) ku të pasqyrohet e gjithë veprimtaria dhe vendimmarrja e kësaj drejtorie (H-I).

-Publikimi i përdorimit të fondeve publike në periudha 3-mujore dhe vjetore për programin “Planifikim,menaxhim,administrim” për çdo llogari ekonomike .

-Në zbatim të legjislacionit të shërbimit civil, do të publikohet çdo vend vakant i krijuar në institucion, si dhe gjithë procedura që do të ndiqet deri në shpalljen e fituesit, në mënyrë që çdo aplikant të marrë njoftimin e nevojshëm për aplikimin për vendin e lire të punës.

III.IV BASHKËPUNIMI ME PERSONAT E KONTAKTIT/TË NGARKUAR

Me financimin e Komisionit të Bashkimit Evropian në datë 7 Janar 2013 filloi implementimin Projektit i ri IPA 2009 “Mbështetje Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KMDP) për trajnimin e Personave të Kontaktit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Sektorin Publik Shqiptar”. Projektin synonte që, nëpërmjet ofrimit të asistencës teknike ndaj Autoritetit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KMDP), të trajnojë Personat e Kontaktit(DPO) për Mbrojtjen e të Dhënave të sektorit publik në përputhje me udhëzimin e KMDP-së Nr.21, datë 24.09.2012 “Për Përcaktimin e Rregullave për Ruajtjen e Sigurisë së të Dhënave Personale të Përpunuara nga Kontrolluesit e Mëdhenj ”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 136 e datës 18 tetor 2012.

■ Kanali i komunikimit me Personat e kontaktit/të ngarkuar

Me miratimin e Kanalit të Komunikimit dhe përdorimin e tij në faqen zyrtare të autoritetit, personi i ngarkuar i KMDP-së informon personat e kontaktit të kontrolluesve publikë të cilët janë pajisur me çertifikatat përkatëse, mbi miratimin e çdo Urdhëri që miraton Komisioneri, apo të çdo iniciative të ndërmarrë,të çdo opinionit të publikuar apo shpjegues të dhënë.

■ Bashkëpunimi me ASPA

Siç dihet tanimë, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) është institucion i krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, në varësinë e ministrit

të Brendshëm. Ajo ka për qëllim formimin profesional të nëpunësve të administratës publike. Kjo do të realizohet nëpërmjet programeve cilësore të trajnimit të administratës publike në përputhje me nevojat reale për trajnim që do të ofrohen nga ekspertët më të mirë shqiptarë dhe të huaj, duke iu referuar kurrikulave bashkëkohore.

Projekti “*Mbështetje ndaj Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KMDP) lidhur me Trajnimin e Personave të Kontaktit/personat e ngarkuar për Mbrojtjen e të Dhënave në Sektorin Publik Shqiptar*”, ka përfunduar trajnimin e 8-të punonjësve të Autoritetit të Komisionerit dhe i ka certifikuar si Trajnerë për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në këtë kuadër, janë hartuar në bashkëpunim me Projektin edhe **kurrikulat e trajnimit** të cilat u përdorën fillimisht për trajtimin e Personave të Ngarkuar dhe tashmë janë miratuar dhe kanë nisur të përdoren edhe nga ASPA për trajnime të mëtejshme të Administratës Publike.

Vlen për tu përmendur hartimi dhe botimi nga Projekti në bashkëpunim me KMDP i “Udhëzuesit praktik për Personat e Kontaktit/ të ngarkuar për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Ky dokument është në vënë dispozicion për të gjithë Personat e Ngarkuar si dhe për Shkollën Shqiptare të Administratës Publike ASPA.

Për këtë qëllim, Autoriteti i Komisionerit në vitet në vijim pas përfundimit të fazës së parë të trajnimit, do të arrijë:

- ▶ Trajnimin e vazhdueshëm të administratës publike duke rritur nivelin e njohjes e të ndërgjegjësimit mbi mbrojtjen e të dhënave personale.
- ▶ Bashkëpunimin për trajnimin e mëtejshëm të 35 e më shumë personave të kontaktit të kontrolluesve publik apo me dhënien e asistencës për zbatimin e përgjegjësive të tyre.
- ▶ Shtrirjen e caktimit dhe trajnimit si “Persona Kontakti” edhe për institucionet private.
- ▶ Komunikime të përditësuara dhe të vazhdueshme me personat e kontaktit/të ngarkuar.
- ▶ Në kuadër të bashkëpunimit me ASPA (Akademinë Shqiptare të administratës publike), bashkërendimin e mundësisë së kontaktit me personat e trajnuar me qëllim identifikimin dhe shtimin e fluksit të prurjeve të reja për trajnim bazë nga institucionet ku ata veprojnë.

■ Bashkëpunimi me shkollën e magjistraturës dhe Rektoratin.

Duke ditur që Shkolla e Magjistraturës ka si mision të përgjithshëm rritjen e cilësisë në dhënien e drejtësisë si shërbim ndaj qytetarëve dhe forcimin e shtetit ligjor nëpërmjet formimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve me integritet, aftësi dhe cilësi të larta profesionale dhe etike, është shumë e rëndësishme që magjistratët, gjyqtarët dhe prokurorët të trajnohen për të marrë njohuri të përgjithshme por edhe të thelluara mbi mbrojtjen e të dhënave personale. Mbrojtja e të dhënave personale konsiderohet një e drejtë themelore e të drejtave të njeriut dhe përbën njëkohësisht një fushë relativisht të re në realitetin shqiptar e cila kërkon shumë përpjekje për ndërgjegjësimin dhe familjarizimin me këtë të drejtë, veçanërisht të aktorëve që do të kontribuojnë në garantimin e të drejtave të qytetarëve.

Gjithashtu Autoriteti i Komisionerit në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të arritur me Rektoratin synon të përfshijë në kurrikulat mësimore edhe mbrojtjen e të dhënave personale e kjo në të gjitha fakultetet.

Për këtë qëllim Autoriteti i Komisionerit do të përkushtohet në:

- ▶ Forcimin e bashkëpunimit institucional me Shkollën e Magjistraturës.
- ▶ Përfshirjen e kurseve mbi mbrojtjen e të dhënave personale në programet e trajnimit vazhdues për të rritur nivelin e kualifikimit dhe përditësimin me legjislacionin e Bashkimit Europian në këtë fushë.
- ▶ Përgatitjen e kurrikulave dhe të moduleve të trajnimit nga ekspertët e KMDP-së në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës.
- ▶ Përfshirjen e kurrikulave për mbrojtjen e të dhënave personale në të gjitha fakultetet.

Bashkëpunimi me drejtoritë e KMDP	D.R ; D.M.P
Bashkëpunimi me Institucionet Publike	Kryesisht me të gjitha Institucionet publike që kanë caktuar Personin e Ngarkuar. ASP/Rektorati/Magjistratura,etj.
Bashkëpunimi me organizma ndërkombëtarë	

III.V PËRMIRËSIMI I BURIMEVE NJERËZORE, TEKNIKE DHE ORGANIZATIVE

Bazuar në synimet strategjike për projekte që do të realizohen gjatë viteve 2014-2017 kemi detyrimin të investojmë vazhdimisht në rritjen e kapaciteteve njerëzore, teknike dhe organizative. Kjo do të arrihet nëpërmjet:

Zhvillimit të politikave dhe praktikave mbi menaxhimin e burimeve njerëzore të cilat do të kosistojnë në:

Mbikqyrjen e vazhdueshme të zbatimit të politikave të shërbimit civil për rekrutimin e një stafi civil jo-politik, profesional, bazuar në merita dhe i mirë menaxhuar.

Zbatimin e ndryshimeve në legjislacionin për shërbimin civil, për të mundësuar reduktimin e subjektivizmit në procesin e konkurimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve të kualifikuar profesionalisht.

Në kuadër të zhvillimit dhe ngritjes së aftësive profesionale të kapaciteteve njerëzore synohet për gjatë vitit 2014 e në vijim:

- ▶ Kryerja e vlerësimit të nevojave për trajnim gjatë dhe pas përfundimit të procesit të vlerësimeve vjetore, e cila do të realizojë dhe hartimin e planit të trajnimeve për vitin aktual bazë dhe në vijim.
- ▶ Zbatimi i një politike efektive e trajnimit për të zhvilluar aftësitë profesionale të punonjësve të KMDP në fusha të përgjithshme dhe specifike.

Për realizimin e këtij objekti të Komisionerit një rol të rëndësishëm zë edhe struktura organizative. Struktura aktuale organizative, ka mundësuar ruajtjen e një shkalle hierarkike të përshtashme për punonjësit dhe mbulimin e funksioneve të KMDP-së.

Gjatë hartimit të PBA-së kemi kërkuar dhe punonjës të tjerë, në Drejtori të ndryshme, me qëllim që struktura jonë të bëhet më e përshtatshme për realizimin sa më mirë të objektivëve të Komisionerit dhe për të ofruar dhe garantuar përmbushje të misionit të ekzistencës së tij. Aktualisht në strukturë ne kemi 29 punonjës, e cila në kushtet aktuale përmbush në masën dhe përqindjen më të madhe realizimin e objektivave tona. Me zgjerimin e aktivitetit, në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë për rritjen e ndërgjegjësimit jo vetëm të kontrolluesve publikë e privatë, por të gjithë publikut, kërkohet një numër më i madh burimesh njerëzore.

Zhvillimi organizativ i institucionit si rrjedhojë e ndryshimit të legjislacionit, kërkon një strukturë e cila duhet ti përgjigjet trendit si dhe standarteve bashkëkohore. Kjo do të sjellë ndryshime në përcaktimin e rregullave të brendshme të institucionit.

► Menaxhimi i të dhënave të burimeve njerëzore, i cili do të realizohet:

- Duke përditësuar të dhënat e regjistruara në burimet njerëzore, për të siguruar në këtë mënyrë saktësinë e tyre në çdo kohë.
- Duke siguruar dosjet e personelit dhe hartuar një plan të shkruar për sigurinë e informacionit të punonjësve. Është e kuptueshme se natyra e shpejtë e ndryshimit të teknologjisë do të paraqesë domosdoshmërinë e ndryshimeve edhe në aspekt të sigurisë. Nga vetë natyra e tyre dosjet e personelit kërkojnë konfidencialitet e ruajtje të sigurt. Informacioni që përfshihet në këto dosje, nga vetë natyra e tij, konsiderohet personal dhe i ndjeshëm për punëmarrësin. Për këtë arsye është e domosdoshme që të përditësohen hapat për t'u siguruar se nuk dhunohet fshehtësia e tyre, në varësi të zhvillimeve aktuale. Dosjet e kompjuterizuara do të kërkojnë përmasë të re për kujdesje ndaj sigurisë dhe do të bëhet çdo përpjekje që versionet e kompjuterizuara të jenë po aq të sigurt sa edhe dosjet tradicionale.
- Me krijimin e një sistemi të automatizuar informacioni të menaxhimit të burimeve njerëzore, i cili do të përdoret për menaxhimin dhe monitorimin efikas dhe efektiv të burimeve njerëzore në të gjitha nivelet.
- Përmes sigurimit të një sistemi të drejtë, transparent dhe të barabartë për menaxhimin e karrierës lidhur me emërimin, vlerësimin dhe ecurinë. Marrja e masave që secili punonjës i stafit të ketë një rishikim vjetor dhe paraqitje të vërejtjeve (nëse ka të tilla) për punën e tyre me qëllim identifikimin e çështjeve të dobëta të performancës në një fazë të hershme, ndërmarrje e hapave të nevojshme për korrigjimin e tyre dhe monitorimin e progresit.

III.VI MENAXHIMI EFEKTIV I BURIMEVE FINANCIARE

Komisioneri për Mbrojtjen e të dhënave personale ka krijuar dhe monitoruar një sistem të menaxhimit financiar dhe kontrollit, i cili është mbështetur në legjislacionin në fuqi, konformë dispozitave të Ligjit 10296, datë 8/07/2010 “Mbi menaxhimin financiar e kontrollin” si dhe mbi parimet e menaxhimit të fondeve publike me efektivitet, transparencë, ekonomi dhe efikasësi.

Ky sistem është një proces i cili ofron dhe jep garanci të arsyeshme për arritjen e objektivave nëpërmjet:

- Efektivitetit dhe efikasësisë së operacioneve;
- Pajtuëshmërisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Besueshmërisë në raportimet financiare e menaxheriale;
- Mbrojtjes së aktiveve.

Sistemi i Menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësinë tonë organizative përfshin tërësinë e masave për menaxhimin dhe kontrollin e të gjithë të ardhurave të krijuara në institucion, shpenzimet si dhe aktivet e krijuara.

Garantimi i këtij procesi dhe respektimi i parimeve bazë të tij arrihet nëpërmjet krijimit dhe kombinimit të kontrollit, të të gjithë komponentëve të sistemit.

- Mjedisi i kontrollit
- Menaxhimi i riskut
- Aktivitetet e kontrollit
- Informacioni e komunikimi
- Monitorimi

Realizimi i këtij objekti do të arrihet nëpërmjet:

- ▶ Forcimit, bashkëpunimit dhe përfshirjes së të gjithë menaxherëve në lidhjen logjike, planifikim, buxhetim, monitorim dhe raportim.
- ▶ Përmirësimit të planifikimit dhe administrimit të mirë të burimeve financiare publike përmes:
 - zbatimit dhe konsolidimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përputhje me standardet e miratuara kombëtare e ndërkombëtare, planifikimit realist, buxhetimit dhe ekzekutimit efikas;
 - përmirësimit të performancës dhe rritjen e efikasitetit të kontrollit të brendshëm.
- ▶ Realizimit të përdorimit me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi të shpenzimeve buxhetore, nëpërmjet:
 - Hartimit të një udhëzuesi mbi procesin e planifikimit të buxhetit, stafit përgjegjës për përgatitjen dhe shkrijen e aktiviteteve me fondet.
 - Përcaktimit sa më real të treguesve të vlerësimit të rezultateve, të cilët do të jenë bazë për monitorimin vjetor, mbi baza performance të çdo rezultati (produkti), pjesë e së cilës do të jetë edhe analiza e riskut ekzistent, minimizimit të mundësisë së ndodhjes si dhe identifikimit të risqeve të reja.

Menaxhimi i riskut është një koncept i ri, i cili kërkon një trajnim të vazhdueshëm nëpërmjet strukturave të ngarkuara për standartizimin dhe implementimin e plotë të Ligjit të menaxhimit financiar dhe kontrollit (MF) i cili do të shikohet në planin afatmesëm dhe afatgjatë.

Në këtë kuadër është hartuar strategjia për menaxhimin e riskut, si dhe është miratuar regjistri i riskut për vitin 2013, ku mbetet synim (afatshkurtër dhe

afatmesëm) analiza e riskut ekzistent dhe marrja e masave në të ardhmen për ti minimizuar ose adresuar ato në nivele të tjera.

Mirëmenaxhimi i riskut, do të japë siguri, garanci dhe është një vlerë e shtuar e menaxhimit institucional mbi realizimin e objektivave të tilla si: ofrimin e shërbimeve cilësore, përmirësim të efikasitetit, vendimmarrje më të besueshme, mbështetje të risive brenda kornizave ligjore, zhvillim të sistemit të buxhetimit dhe kontabilizimit për të siguruar shpërndarjen dhe matjen e saktë të kostove të aktiviteteve, në funksion të realizimit të objektivave.

- ▶ Forcimit të kontrollit të brendshëm, në të gjithë komponentët e tij, i cili synon të garantojë në një nivel të caktuar sigurie se objektivat dhe përgjegjësitë po plotësohen në përputhje me funksionet dhe kompetencat ligjore.
- ▶ Rritjes së përgjegjshmërisë së çdo niveli hierarkik, në kontekstin e menaxhimit, për të dhënë garanci dhe siguruar se:

Menaxhimi është efektiv.

Gjithçka kryhet nëpërmjet rregullave.

Kontabilizimi kryhet sipas procedurave.

Fondet përdoren sipas ligjeve financiare.

IV. PLATFORMAT E REJA TEKNOLOGJIKE TË E-GOVERNMENT NË LINJË ME MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DHE BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL.

Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për të përmirësuar aktivitetet e administratës publike po aplikohet së fundmi edhe nga Qeveria Shqiptare (E-Government).

Ky ndërveprim teknik i cili do të implementohet në disa fusha si, prokurimi elektronik, taksimi elektronik, regjistrimi i biznesit, menaxhimi i integruar i kufijve, doganat elektronike, arsimit dixhital, e-Health etj, në çdo rast duhet të

zbatojnë parimet e mbrojtjes së të dhënave në përpunimin e të dhënave personale.

Gjithashtu, Cloud Computing mund të përbëjë një dukuri krejtësisht të re për disa persona, megjithatë tashmë është kthyer në fakt, për të cilin shumë njerëz nuk janë të ndërgjegjshëm. Njëkohësisht, Cloud Computing përbën një rrezik të madh ndaj privatësisë, i cili mund të shmangët fillimisht nëpërmjet rregullimeve nënligjore edhe pse këto teknologji po përparojnë gjithnjë e më shpejt.

Për realizimin e këtij objekti dhe për funksionimin me sukses të këtyre sistemeve duhet që mbrojtja e të dhënave të mbahet parasysh që në dizejnim të arkitekturës së sistemit të informacionit të të dhënave duke siguruar në këtë mënyrë besimin si për administratën publike ashtu dhe për qytetarët.

Zhvillimi i kuadrit ligjor për mirëfunksionim e këtyre sistemeve apo nxitja për të përcaktuar politikën e privatësisë në këto sisteme, do të kërkojë bashkëpunimin e vazhdueshëm me institucionet përkatëse që t'i implementojnë.

Autoriteti i Komisionerit do të synojë:

- ▶ Marrjen e masave për nxitjen e institucioneve për hartimin e politikave të privatësisë.
- ▶ Miratimin e një akti nënligjor për mbrojtjen e të dhënave në “cloud computing”.
- ▶ Marrjen e masave për të siguruar mbrojtje efektive të të dhënave që në dizejnim të arkitekturës së sistemit të informacionit të të dhënave (privacy by design).
- ▶ Bashkëpunim të ngushtë me institucione të ndryshme.

Bashkëpunimi me drejtoritë e KMDP	D.H.I ; DMP(Sektori IT)
Bashkëpunimi me Institucionet Publike dhe Private	Kryeministria, MD, MB, M.Punës dhe Mirëqenies Sociale, MSH, M/Inovacion dhe Administratën Publike, MASH, AKEP, AKSHI, etj. Vodafone Albania, EAGLE mobile, AMC
Bashkëpunimi me organizma ndërkombëtarë	Specifika e fushës kërkon asistencën e Ekspertëve të ofruar nga TAIEX, KE apo projekte të tjera të ngjashme.

V. MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE

Autoriteti ynë luan rol të rëndësishëm ndërkombëtar dhe rajonal, i cili është në zhvillim dhe shtrirje konstante. Detyrimet dhe përgjegjësitë e përgjithshme në bashkëpunimin ndërkombëtar përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të punës sonë. Me qëllim forcimin dhe rritjen e ndikimit të institucionit tek publiku, me anë të përafrimit, përputhjes dhe përshtatjes së kuadrit ligjor, me organizmat e fushës së mbrojtjes së të dhënave në BE por edhe me organizatat dhe aktorët e tjerë, marrëdhëniet e Autoritetit të KMDP-së me to duhet të zhvillohen edhe më tej.

Hapat për t'u ndërmarrë në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe detyrave që lidhen drejtpërdrejt apo tërthorazi me mbarëvajtjen institucionale të Autoritetit tonë, fokusohen në:

- ▶ Zhvillimin e mëtejshëm dhe më intensiv të komunikimit, shkëmbimit të eksperiencës, të informacionit me organizmat në të cilat Autoriteti ynë është tashmë palë.
- ▶ Promovimin e punës së Autoritetit tonë në kuadër të mbledhjeve, konferencave apo evenimenteve të ndryshme që organizohen nga institucionet homologe.

- ▶ Publikimin e artikujve, shkrimeve, lidhjeve të ndryshme, në revistën e Autoritetit të KMDP-së, ku të paraqitet niveli i përditësimit të institucionit tonë nën dritën e zhvillimeve ndërkombëtare, si në çështjet e legjislacionit ashtu edhe të aktualitetit të mbrojtjes së të dhënave.
- ▶ Shtrirjen e bashkëpunimit drejt autoriteteve homologe, në kuadër të inspektimeve të përbashkëta që mund të kryhen pranë kompanive ndërkombëtare që operojnë në vendin tonë, të cilat do të ishin frytdhënëse në shkëmbimin e eksperiencës, rasteve praktike dhe lidhjen më të ngushtë ndërmjet Autoritetit tonë dhe atyre rajonalë e më gjerë.
- ▶ Pasurimin e bibliotekës së institucionit me përkthime të botimeve, përditësime, aktualitet, kërkime në fushën e mbrojtjes së të dhënave, të nevojshme për përmirësimin e metodologjisë së aksioneve tona.
- ▶ Pasurimin në gjuhën angleze të faqes zyrtare të Autoritetit të KMDP-së, si kusht për përfaqësimin ndërkombëtar të institucionit.
- ▶ Pasurimin në gjuhën frënge të faqes zyrtare të Autoritetit të KMDP-së, si arritje në bashkëpunimin me Shoqatën Frankofone.
- ▶ Dhënien e mendimeve mbi akte ndërkombëtare/rekomandime, etj.
- ▶ Bashkëpunimin me projektet e KoE dhe TAIEX për arritjen e objektivave kur kjo shihet e nevojshme duke realizuar termat e referencës dhe përfitimin e tyre në kuadër të evidentimit në rolin e përfituesit/rezultate të pritshme konkrete.

■ **Bashkëpunimi me agjencinë e Bashkimit Evropian EUROJUST**

Në kuadër të bashkëpunimit të Ministrisë së Drejtësisë me EUROJUST, Autoriteti i Komisionerit ka filluar raportimin pranë kësaj agjencie që në vitin 2010. Në vijim dhe në mënyre graduale erdhi edhe bashkëpunimi i frytshëm midis Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë së Përgjithshme dhe KMDP-së. Kjo arritje u iniciua nga projekti IPA -2009 që asistoi KMDP dhe projekti i Binjakëzimit “Mbështetje ndaj Strukturave të Hetimit kundër Pastrimit të Parave dhe Krimeve Financiare” që asistonte organin e Prokurorisë. Në këtë kuadër u zhvilluan një sërë takimesh të përbashkëta të cilat u finalizuan me një Vizitë Studimore në institucionin e Eurojust, në Hagë në vitin 2012.

Nga ana e Eurojust është vlerësuar me shumë interes nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit midis tyre dhe organeve tona, dhe falë angazhimit maksimal të KMDP-së në punën pozitive të bërë e të treguar në mbrojtjen të privatësisë thuajse kjo marrëveshje është drejt finalizimit.

Gjatë vitit 2012 për Eurojust është caktuar edhe personi i kontaktit me KMDP, i cili informon mbi ecurinë e punës së përbashkët në këtë agjenci të rëndësishme në BE dhe bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me Ministrinë e Drejtësisë.

Në vitet në vijim Autoriteti i Komisionerit do të synojë:

- ▶ Bashkëpunimin e vazhdueshëm nëpërmjet raportimeve periodike pranë EUROJUST.
- ▶ Finalizimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet KMDP dhe EUROJUST.

■ **Bashkëpunimi me T-PD**

Angazhimi i pjesëmarrjes së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale në Komitetin Konsultativ mbi Konventën për Mbrojtjen e Individëve nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale (T-PD) prej vitit 2009, ka mundësuar njohjen e Autoritetit tonë në arenën ndërkombëtare, shkëmbimin e eksperiencës së përbashkët por dhe krijimin e lidhjeve me ekspertë të lartë në fushën që ne mbulojmë.

Gjithashtu, në kuadër të detyrimeve që rrjedhin nga pjesëmarrja me të drejtë vote në T-PD, KMDP angazhohet në dhënien e mendimit në rastet kur një shtet i ri aspiron të ketë statusin e vëzhguesit në Komitet por dhe jep mendimin për akte të ndryshme të dërguara për mendim. Gjatë vitit 2013, Autoriteti i Komisionerit ka shënuar një rritje të bashkëpunimit me këtë Komitet gjë që aspiron ta përçojë edhe në vitet në vijim.

Autoriteti i Komisionerit do të synojë:

- ▶ Bashkëpunimin e vazhdueshëm nëpërmjet raportimeve periodike pranë T-PD;
- ▶ Dhënien e mendimeve brenda afateve të përcaktuara për aktet e dërguara për mendim;
- ▶ Përfitim të eksperiencës më të mirë ndërkombëtare.

■ **Organizimi i Konferencës Rajonale me autoritetet e mbrojtjes së të dhënave personale të vendeve të Evropës Qëndrore dhe Lindore**

Autoriteti i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale u pranua anëtarë me të drejta të plota në këtë konferencë, në vitin 2010 në Takimin e 12-të

mbajtur në Sopot të Polonisë. Që prej këtij viti, Autoriteti i Komisionerit ka marrë pjesë në të gjitha takimet e organizuara nga Asambleja e Autoriteteve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Evropës Qendrore dhe Lindore (CEEDPA).

Duke qenë se:

- ▶ Autoriteti i Komisionerit ka plotësuar me sukses objektivat e parashikuara gjatë 5 viteve të themelit të saj;
- ▶ Autoriteti u përzgjedh si Fitues i Çmimit të Dytë, për kategorinë: Projektet më të Mira të Përfunduara, ndërmjet 300 projekteve të ekspozuara nga gjithë Evropa në konkursin “Projektet më të mira IPA 2013” organizuar nga Shoqata e Projekteve Evropiane, çmim ky, i dhënë për projektet e financuara nga Bashkimi Evropian të cilët kanë një ndikim të madh pozitiv, për ndryshimet dhe përmirësimet sociale dhe kjo arritje falë bashkëpunimit të frytshëm me projektin IPA-2009 “Për Konsolidimin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Shqipëri në Përputhje me Standardet e Bashkimit Evropian” dhe,
- ▶ Ekziston dëshira e mirë për të bashkëpunuar me autoritetet homologe kryesisht me ato të rajonit;

Autoriteti i Komisionerit do të angazhohet plotësisht për organizimin e konferencës së radhës në Republikën e Shqipërisë duke ndjekur të gjitha procedurat zyrtare për aplikimin përkatës. Pa dyshim që është një event shumë i rëndësishëm dhe kërkon përkushtim maksimal si dhe parashikim buxhetor për të arrirë atë që dëshirojmë.

■ Organizimi i Konferencës së Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Frankofonisë në Shqipëri.

Shoqata Frankofone e Autoriteteve të Mbrojtjes së të dhënave personale (AFAPDP) është krijuar në vitin 2007. Ajo përfshin autoritetet e mbrojtjes së të dhënave personale (16 anëtarë deri në vitin 2012) dhe vendet frankofone që nuk kanë miratuar ende ligj në këtë fushë (anëtarë vëzhgues të AFAPDP-së).

AFAPDP-ja është një **rrjet i promovimit të së drejtës** për mbrojtje të të dhënave personale dhe shkëmbimit të praktikave të mira. Aksionet e saj kontribuojnë në miratimin e ligjeve të mbrojtjes së të dhënave personale, deri te ngritja e autoriteteve të pavarura të kontrollit dhe tek harmonizimi i praktikave.

AFAPDP-ja synon gjithashtu të marrë pjesë aktivisht në bashkëpunimin ndërkombëtar dhe në debatin ndërkombëtar mbi vlerësimin e së drejtës për

mbrojtje të të dhënave personale, në kuadër të së cilës ajo ka si qëllim të ngrejë zërin e **vlerave humaniste të Frankofonisë**.

AFAPDP-ja është anëtare e Rrjeteve Institucionale të Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë (OIF)

Autoriteti Shqiptar i Mbrojtjes së të Dhënave Personale është anëtar i kësaj Shoqate që prej vitit 2009, vit ku për herë të parë mori pjesë në Konferencën e Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Frankofonisë e cila u organizua atë vit në Madrid - Spanjë. Në kuadër të anëtarësimit në këtë shoqatë, KMDP çdo vit paguan kuotizacionin e nevojshëm për të përfituar më pas asistencën dhe shërbimet e tjera nga kjo shoqatë, një ndër to dhe pjesëmarrjen në konferencën vjetore.

Në mbledhjet e radhës KMDP do të kërkojë zyrtarisht organizimin e kësaj konference në Republikën e Shqipërisë.

■ **Ndjekja në vazhdimësi e Projektit “Joint Project of the Balkan Data Protection Authority”.**

Ky projekt ka si qëllim të krijojë një bashkëpunim të fortë rajonal në ndërtimin e kapaciteteve të Autoriteteve për mbrojtjen e të dhënave nga vendet e Ballkanit dhe bashkëpunimin e tyre me institucionet përgjegjëse kombëtare që kanë të bëjnë me policinë dhe drejtësinë për të përmirësuar mbrojtjen e të dhënave si dhe harmonizimin e ligjeve dhe praktikave kombëtare me standardet e BE-së.

Bashkëpunimi, në të njëjtën kohë, do të ulë kostot dhe implementimin e programeve individualisht nga secili vend përmes shkëmbimit të praktikave më të mira.

■ **Aplikim për përfitim të projekteve, vizita studimore, trajnime në kuadër të instrumenteve financuese të BE-së apo rrjeteve të ndryshme në fushën e mbrojtjes së të dhënave.**

Autoriteti i Komisionerit e shikon si prioritet vazhdimin e trajnimit të stafit të tij me ekspertët më të mirë ndërkombëtarë, workshop-e, vizita studimore për të përthithur eksperiencën ndërkombëtare dhe sigurimin e një niveli të lartë të njohurive të stafit si dhe përfitimin e projekteve në vazhdim për të realizuar të tjera pritshmëri si në kuadrin ligjor apo edhe atë monitorues e ndërgjegjësues.

Bashkëpunimi me drejtoritë e KMDP	DMP; D.H.I, D.SH.M
Bashkëpunimi me Institucionet Publike	Kryeministria, Ministri për Marrëdhëniet me Parlamentin, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Integritit European ,etj.
Bashkëpunimi me organizmat ndërkombëtarë	T-PD, Frankofoninë dhe autoritetet e tjera homologe.



REZULTATET E PRITSHME

Në çdo rast KMDP do të tregojë vendosmëri në zbatimin e ligjit duke ofruar zgjidhje të pranueshme nga çdo kontrollues, bazuar edhe në trendin e ndjekur nga autoritetet homologe europiane. Ndërgjegjësim i subjekteve kontrolluese, inspektime në fusha të reja, informimi i gjerë i publikut për aktet e nxjerra nga Komisioneri, kontrole më të shpeshta në lidhje me zbatueshmërinë e akteve të nxjerra nga Komisioneri.

Autoriteti i Komisionerit nga veprimtaria kontrolluese dhe inspektuese do të arrijë:

- ▶ Të ndërgjegjësojë subjektet e të dhënave mbi të drejtat që kanë dhe si duhet ti realizojnë;
- ▶ Të ndërgjegjësojë kontrolluesit mbi detyrimet ligjore që kanë;
- ▶ Të forcojë dhe konsolidojë Komisionerin si autoritet përgjegjës i pavarur;
- ▶ Bashkëpunim sa më efikas mes strukturave të KMDP dhe të gjithë aktorëve.
- ▶ Të rrisë bashkëpunimin me kontrolluesit;
- ▶ Të përcaktojë problematikat dhe të intensifikojë përpjekjet për të shmangur shkeljet;
- ▶ Të garantojë implementimin e masave të marra ndaj kontrolluesve dhe të shmangë përsëritjen e shkeljeve;
- ▶ Të ulë numrin e shkeljeve ligjore;
- ▶ Të Intensifikojë përpjekjet për kapjen, ndërprerjen dhe parandalimin e shkeljeve.

<p>Ndërgjegjësimi i kontrolluesve dhe përpunuesve në respektimin e ligjit 9887 datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale” gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.</p>	<p>KMDP</p>
<p>Ndërgjegjësimi i subjekteve të të dhënave personale të cilët në raste të keqpërdorimit të të dhënave të tyre personale nga kontrollues apo përpunues të ndryshëm të orientojnë ankesat e tyre drejt Komisionerit për Mbrojtjen e të dhënave personale.</p>	<p>KMDP</p>
<p>Në rang kombëtar Strategjia do të shërbejë për forcim, konsolidim të Autoritetit të Komisionerit si i vetmi autoritet përgjegjës i pavarur, që mbikëqyr dhe monitoron, në përputhje me ligjin, mbrojtjen e të dhënave personale, duke respektuar e garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.</p>	<p>KMDP</p>
<p>Në rang ndërkombëtar Autoriteti i Komisionerit të njihet si një autoritet i pavarur i qëndrueshëm, që garanton mbrojtjen e të dhënave personale, i aftë dhe i gatshëm për anëtarësim në organizma dhe forume të rëndësishme në fushën e privatësisë në BE, drejt synimit të anëtarësimit me të drejta të plota, si kundër synon i gjithë vendi.</p>	<p>KMDP</p>